



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi \_ dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtrues i panjohur (anonim), Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

#### **VENDIM**

Procedura për lëndën nr.12-5194 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-5194/1 me datë 14.11.2019, dorëzuar nga parashtrues i panjohur, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-5194 nga viti 2019, për rastin nuk janë vërtetuar akuzat e lëndës.

Lënda me numër 12-5194 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

#### **SQARIM**

Lënda me numër 12-5194 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-5194/1 me datë 14.11.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtrues i panjohur – anëtar të revoltuar të .....

Në denoncim flitet për akuza kundër ISHP Qendra për shëndet publik ..... për pagesë joligjore në bazë të angazhimit të personit me kontratë në vepër në periudhën për vitet 2018-2019, kurse parashtruesit e denoncimit dyshojnë se personi i angazhuar është i punësuar partiak / i angazhuar në institucionin e shëndetësis publike të përmendur dhe kërkojnë që të hulumtohet rasti.

Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza për angazhim joligjor të personit ..... i cili ka qenë në moshë rreth 60 vjeçar në llogarin për transaksione të tij janë lëshuar mjete finansiare nga Instituoni i përmendur në bazë të angazhimit të tij me kontratë në vepër. Në denoncimin e dorëzuar theksohet se në lidhje me rastin e lëndës është dërguar denoncim deri tek inspektorati i punës, me çka pas kërkesës me personin e angazhuar me marrëveshje është ndërprerë kontrata me Qendrën e shëndetit publik ....., mirëpo, pas periudhe të shkurtë kontrata përsëri u rinovua dhe ai ka vazhduar me punën, kurse me datë 08.11.2019 është shpallur konkurs me të cilën kërkohet punësimi i tre punëtorëve, me të cilën parashtruesi dyshon se një pozicion i punës është paraparë në atë mënyrë që të përgjigjet punësimi të personit të angazhuar.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Qendra për shëndet publik ..... për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve në lidhje me akuzat

e lëndës. Në lidhje me kërkesën e dorëzuar të KSHPK, me datë 21.05.2019 është marrë përgjigje nga ISHP Qendra për shëndet publik - ..... dhe pas rishikimi të përgjigjes me shtojcë dokumentacion, KSHPK konstatoi këtë:

- Personi i përmendur ..... ka qenë i angazhuar për periudhën prej 03.09.2018 deri në 31.12.2018 në pozicionin – teknik kimik me kontratë në veprë për nevojat e Qendrës për shëndet publik ..... në përputhje me pëlqimin e miratuar nga Ministria e shëndetësisë dhe të finansave me datë 16.08.2018, e cila është dhënë në përputhje me dispozitat e nenin 9 nga Ligji për transformim në marrdhënje të rregulltë pune.
- Me kërkesë për pëlqim për vazhdim të pëlqimit të personit të angazhuar me kontratë në veprë në ISHP Qendra për shëndet publik ..... për vitin 2019, dorëzuar deri tek Ministria e shëndetësisë, ka pasur vazhdim të pëlqimit të fituar nga Ministria e finansave me datë 30.01.2019 dhe personi i njëjtë është angazhuar përsëri për periudhën 01.02.2019 deri në 15.11.2019. Pastaj, me kërkesë të personit të angazhuar me datë 15.11.2019 është ndërprerë kontrata përshkak të nevojave të veta personale ....., kurse i njëjti është rinovuar me datë 20.11.2019, kur është angazhuar si vozitës, ekonomis-nikoqir edhe kjo kontratë me marrveshje është ndërprerë me datë 20.12.2019.
- Në informimin e dorëzuar institucioni i shëndetit publik thekson se kontratat e përkohshme – kontratë në veprë janë nënshkruar në përputhje me nenin 9 nga Ligji për transformim në marrdhënje të rregullt pune (Gazeta zyrtare e RM nr.20/2015) sipas të cilit pëlqim për personin e angazhuar me kontratë në veprë ka dhënë Ministria e finansave dhe me kërkesë dërguar nga ana e Ministrisë së shëndetësisë.
- Me datë 18.09.2019 nga ana e ISHP Qendra për shëndet publik ..... është dorëzuar kërkesë për fitim të pëlqimit për punësim dhe nënshkrim të marrëveshjes për punësim në kohë të pacaktuar, deri tek Ministria e shëndetësisë për nevojat e rregullimit të statusit të personit të angazhuar me kontratë në veprë deri me datë 31.12.2019, me të cilën kërkohet punësim i tre personave në kohë të pacaktuar për kryerjen e detyrave të punës në këtë qendër, kurse në mes të cilave është paraparë punësi i një personi në vendin e punës teknik-kimik. Ministria për shëndetësi në bazë të kësaj kërkesë ka kërkuar pëlqim për punësim dhe me datë 21.10.2019 ka marrë informim nga Ministria e finansave me të cilën informohen se për tre punësimet e lëndës në ISHP Qendra për shëndet publik ..... në kohë të pacaktuar, në Buxhetin e këtij institucioni të shëndetit publik për vitin fiskal rrjedhës (2019) janë siguruar mjetet financiare.
- Pas marrjes së pëlqimit, me datë 21.10.2019, nga ana e UD drejtorit të ISHP Qendra për shëndet publik ..... është shpallur konkurs për tre punësimet e përmendura dhe pas realizimit të procedurës për të njëjtat janë nënshkruar kontratat për punësim të kandidatëve, në mes të të cilëve edhe kontrata me personin ..... për punësim në kohë të pacaktuar në vendin e punës teknik-kimik, në të cilin pozicion ky person dhe momentalisht është i punësuar.

Në bazë të tërë të konstatuarës më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vërtetoi se në rastin e lëndës akuzat e lëndës për pagesë joligjore në institucioni e shëndetësisë publike të përmendur nuk janë vërtetua, me çka vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva  
Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: J. C., këshilltarë  
Miratoi: N. B. anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROR PËR  
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT  
Kryetarë: Biljana Ivanovska**

